



Prishtinë: 02.09.2021

Kodi i ZRRE-së: V\_1377\_2021

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2161\_04\_21** i dt. **16.04.2021**;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **12.05.2021**.

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin Z.B nga Komuna e Podujevës, me shifër të konsumatorit DPR - 78183, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2161\_04\_21, i datës 16.04.2021.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve me datë 16.04.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2161\_03\_21, me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit Z.B dhe e ka obliguar KESCO-n që t'i anulojë faturat 11/2014 – 04/2015, si dhe korrigjimin nr.84513DPR – 78183 të datës 15.03.2016 si dhe është obliguar që për periudhën e anuluar, ta ngarkoj konsumatorin duke u bazuar në shpenzimet e regjistruara në njehsorin e ri elektrik nr.16077830 për periudhën 11/2015 – 04/2016.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka parashtruar Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Faturimi për periudhën 11/2014 – 04/2015 me njehsorin nr. 63980835 është i saktë dhe është bërë sipas gjendjes së regjistruar në njehsor dhe se sipas Raportit të Qendrës së Kalibrimit, është konstatuar se gabimi në matje është +0.27% e që është brenda kufijve të lejuar të matjes.
- ZRrE vendimin e saj e bazon në rrjedhën e energjisë elektrike, mirëpo nuk do të thotë që për periudhën kontestuese, konsumatori nuk e ka shpenzuar atë energji, pasi që leximet e bëra për këtë periudhë janë lexime me pajisjet elektronike HHU, ku të dhënat janë marrë në mënyrë automatike “me sondë” dhe është evituar gabimi në lexim.
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2161\_03\_21 i datës 16.04.2021 për konsumatorin Z.B.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO-s në të cilën pretendohet faturimi është i saktë, Bordi i ZRrE-së e vlerëson si ta paqëndrueshëm, sepse siç edhe mund të shihet nga procesverbali i inspektimit i dt.23.04.2015, vet punëtorët e KEDS-it gjatë inspektimit të pikës matëse kanë konstatuar se njehsori elektrik nr.63980835 nuk bën matje të saktë, dhe për këtë arsye është kërkuar edhe ndërrimi i tij dhe dërgimi në Qendrën e Kalibrimit.

Po ashtu, duke u bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike dhe në listat e leximit, Bordi ka konstatuar se konsumatori ka lexime të rregullta të pikës matëse, përveç kur lexuesi nuk ka qasje në pikës matëse dhe se faturimi i shpenzimeve faturimi i shpenzimeve me njehsorin elektrik nr.08196365 ne periudhat 11/12/2014, dhe me njehsorin nr.63980835 në periudhën 03/2015 nuk përputhen me shpenzimet reale mujore të konsumatorit të regjistruara me herët, si dhe më vonë në njehsorët nr.16077830 dhe nr.53854703.

Pretendimi tjetër që ZRrE vendimin e saj e bazon në rrjedhë të energjisë dhe kjo nuk nënkupton që konsumatori nuk e ka bërë atë shpenzim, Bordi e vlerëson si jo relevant, sepse, analizimi i rrjedhës së energjisë elektrike të një konsumatori, është një nga provat më të rëndësishme në procedurën e zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve, pasi që na mundëson që të kemi një pasqyrë të qartë të profilit të një konsumatori ndër vite. Andaj, edhe në këtë rast, duke u bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike konsumi mesatar i konsumatorit ndër vite nuk përkon as për së afërmi me shpenzimin e faturuar për periudhat kontestuese. Kësisoj, supozimi se “nuk nënkupton që konsumatori nuk e ka bërë atë shpenzim”, si i tillë nuk ka mbështetje në provat materiale si në shkresat e lëndës, pasi që shpenzimi i kontestuar nuk përputhet me shpenzimet reale të konsumatorit para dhe pas periudhës kontestuese, të regjistruara në të dy njehsorët me nr.16077830 dhe nr. 53854703.

Bazuar ne transaksionet e konsumatorit vërtetohet se Departamenti i faturimit me datë 15.03.2016 përmes korrigjimit nr.84513DPR-78183 ka bërë korrigjimin e faturave për periudhën 01/02/03/2015 duke bërë shpërndarjen e kWh të faturuar për këto periudha. Bordi e ka shqyrtuar korrigjimin e bërë nga KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1, 2 dhe 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjerë, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme), 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit dhe 3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”. Edhe përkundër që KESCO ka bërë korrigjimin financiar sipas Rregullës së lartcekur, duhet theksuar se gjatë analizave të bëra shkresave të lëndës, është vërejtur se **konsumi i faturuar për periudhën 01-03/2015 nuk paraqet shpenzim real të konsumatorit**, e që KESCO është dashur ta kishte parasysh gjatë korrigjimit të bërë.*



Deri tek ky konstatim, Bordi i ZRrE-së ka ardhur duke administruar provat si në vijim: Transaksionet e konsumatorit, Procesverbali i inspektimit i dt. 05.03.2015, Procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik të dt. 23.04.2015, Procesverbalin e kontrollimit të njehsorit elektrik të dt.03.02.2016, ankesën e konsumatorit në KESCO, Përgjigjën e KESCO-s, Ankesën e Konsumatorit në DMK të ZRrE-së, Vendimin e DMK-së, Kundërshtimin e KESCO-s, faturat e kontestuara, Rrjedhën e energjisë elektrike. Pra, nga sa u tha më sipër, shihet qartë që shpenzimi i energjisë elektrike i konsumatorit i faturuar në periudhat kontestuese si shpenzim mujor, nuk përputhet as për së afërmi me shpenzimin e konsumatorit të periudhave para dhe pas kontestit.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit Z.B. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar